



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
REKTORI

Nr. 169/13 Prot.

Tiranë, më 28.1.2019

UDHËZIM

Nr. 1, datë 28.1.2019

PËR

**PROCEDURAT E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E  
SPECIALIZIMEVE AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E  
MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019**

Në mbështetje të neneve 18, 70, 71, 77 dhe 89 të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit nr. 3, datë 28.01.2019 të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë "Për miratimin e shpërndarjes së kuotave të pranimit dhe tarifave të shkollimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2018-2019, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", dhe VKM-së nr.1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)", i ndryshuar me VKM nr. 371, datë 26.04.2017, sot Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA),

UDHËZOJ:

1. Kandidatët aplikojnë për një program specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë (UMT), në vitin akademik 2018-2019, respektivisht, në zbatim të Vendimit nr. 3, datë 28.1.2019 të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë "Për miratimin e shpërndarjes së kuotave të pranimit dhe tarifave të shkollimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2018-2019, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë" nga data **04.02.2019 deri më datë 15.02.2019**. Procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe konkurrimit bëhen konform rregullores së specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë të miratuar, nga Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë me Vendimin Nr.88, datë 16.11.2016, e ndryshuar.
2. Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, të organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë. Procesi monitorohet nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
3. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e specializimeve afatgjata, në fushën e mjekësisë, kandidatët që:
  - a. Kanë përfunduar në Republikën e Shqipërisë me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse, në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i

Shkencave", si dhe kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë;

- b. Janë diplomuar jashtë vendit në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MASR, si dhe kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë.

4. Për të aplikuar në programet e specializimit afatgjatë për të cilat janë parashikuar kuota sipas tabelës, bashkëlidhur Vendimit nr. 3, datë 28.1.2019 të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, kandidatët duhet të kenë përfunduar një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në fushën e mjekësisë.

Të gjithë kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e parashikuara në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.

5. Kandidati paraqitet personalisht për të bërë aplikimin dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a. Formular aplikimi, sipas modelit të parashikuar në Shtojcën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi (kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh plotësojnë formularin sipas modelit të parashikuar në shtojcën nr.1a);
  - b. Letër motivimi e aplikantit;
  - c. Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, kartë identiteti ose pasaportë;
  - d. Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e diplomës universitare, të programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" si dhe të ciklit të dytë "Master i Shkencave", ose të programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë, dhe listës / listave të notave. Për rastet e diplomave të huaja paraqitet kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë, e shoqëruar me diplomën /diplomat dhe listën / listat përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në Universitet në vendin ku janë kryer studimet, të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë përkatës. Në rast se njohja e diplomës nuk ka përfunduar ende, kandidati paraqet vërtetim që ka dorëzuar dokumentacionin për njohje në MASR, dhe duhet të dorëzojë dokumentin e njohjes jo më vonë se data e parashikuar për testimin e informatizuar, si dhe përpara shpalljes së rezultatit përfundimtar nga Komisioni i Vlerësimit;
  - e. Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e dokumentit që vërteton njohjen e gjuhës së huaj, sipas përcaktimit në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë përkatësisht "Të zotërojë të paktën një nga gjuhët e huaja (anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht) në nivelin B2, si kriter minimal në programet e studimit të ciklit të tretë të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, me kusht që afati i fundit për paraqitjen e shlyerjes së gjuhës së huaj në nivel C1, sipas akteve nënligjore në fuqi, për këtë kategori studentësh të jetë përpara përfundimit të vitit të parë akademik të programit përkatës.
  - f. Fotokopje e noterizuar e licencës për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë dhe e dëshmisë së regjistrimit në Urdhrin profesional përkatës;
  - g. Dëshmi penaliteti e vlefshme;
  - h. Mandat pagesa për tarifën e konkurrimit (intervistën me gojë) prej 5,000 (pesëmijë)lekë;
  - i. Kandidatët që aplikojnë për kuotat e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Punëve të Brendshme, dorëzojnë një letër mbështetëse të ministrisë përkatëse sipas formatit të parashikuar në Shtojcën nr.2, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
  - j. Dy foto personale.
6. Dekanatet brenda datës **20.02.2019** shpallin në faqen zyrtare ueb të fakulteteve dhe/ose UMT- së listën emërore të kandidateve të regjistruar për konkurrim, të cilët plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në procesin e konkurrimit. Kandidatët brenda 2 ditëve nga shpallja verifikojnë listën emërore